



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 399 Prot.

Tiranë, më datë 13.09.2024

VENDIM

Nr. 351, datë 13.09.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.09.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit “*Godinë banimi dhe shërbime 3-8-10-11 kate, me 1 kat nëntokë*”, lagjja “Hajro Çakërri”, Vlorë, në Zonën Arkeologjike “B” të qytetit të Vlorës, me aplikues Z. Taulant Rama dhe zhvillues **Turi & M.Z.B sh.p.k, me rekomandimin;**
 - Sondazhet arkeologjike të realizohen manualisht dhe pa përdorur mjete mekanike;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji për realizimin sondazhet arkeologjike “*Godinë banimi dhe shërbime 3-8-10-11 kate, me 1 kat nëntokë*”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Rezultati i sondazheve arkeologjike do të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

